

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 18 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 04.05.2023, me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ””.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema
- **Parti Politike** S’ka
- **Të tjerë**

Z. E. Lako: Çelim seancën publike të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes, të kërkesës numër 18, datë 04.05.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Donika Tula, drejtor i shkollës 9-vjeçare “Todi Koçeli” Selenicë, me gjobë 4000 (katër mijë) lekë. Relator jam zgjedhur unë Elvin Lako, në mbështetje të nenit 129 të Kodit Zgjedhor. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe të Sanksioneve, Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Palë të interesuara nuk ka. Vazhdojmë shkurtimisht zoti Merkaj dy fjalë rreth kësaj kërkesë.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim denoncimin nr.... ndaj zonjës Donika Sula, drejtor i shkollës 9-vjeçare “Todi Koçeli” Selenicë,

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

për shkelje administrative në zgjedhjet për organe të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në përfundim të shqyrtimit administrativ Komisioneri ka vendosur ti propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe sanksioneve marrjen e masës administrative për zonjën Donika Sula drejtor i shkollës 9-vjeçare “Todi Koçeli” Selenicë në masën 4000 (katër mijë) lekë. Nga shqyrtimi paraprak i Kërkesës që i drejtohet Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, kërkesë për vendosje sanksioni administrativ. Konstatohet se kërkesa i plotëson elementët formal të parashikuar nga neni 130 i Kodit Zgjedhor, kompetencë, legjitimimin dhe afatin kohor. Në këto kushte kërkojmë që të kalojë për shqyrtim administrativ në seancë publike. Faleminderit!

Z. E. Lako: Ndonjë pyetje ka nga anëtarët e Kasit.

Anëtarët e KAS-it: Jo.

Z. E. Lako: Atëherë Sekretari i Përgjithshëm kërkon qalimin në seancë. KAS i konsultuar në vend vendos kalimin e kësaj çështjeje në seancë. Seanca do të zhvillohet sot në orën 13:30. Ju lutem lajmëroni dhe palën e interesuar. Me kaq senacen e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr. 76

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



RENDI I DITËS

Projektvendim "Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 19, datë 06.05.2023, me objekt "Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ"

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema
- **Parti Politike** S'ka
- **Të tjerë**

Z. E. Lako: Çelim seancën publike të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes, të kërkesës numër 19, të datës 06.05.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me objekt "Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zotit Safet Gjici, kryetar dhe kandidat për Bashkinë Kukës, me gjobë në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë" dhe "Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zotit Betim Lushi, drejtor i shkollës 9-vjeçare "Isuf Seferi", gjobë në masën 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë". Edhe për këtë çështje jam caktuar relator unë, sipas shortit të hedhur në datën 7 maj. Të pranishëm janë si gjithmonë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe të Sanksioneve, Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Palë të interesuara nuk ka, pavarësisht se janë bërë njoftimet apo jo zoti Merkaj?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. Y. Merkaç: Po.

Z. E. Lako: Vazhdojmë shkurtimisht edhe për këtë, për plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes, dy fjalë.

Z.Y.Merkaç: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur denoncimin nr. 335 ID, administruar në Komisionin Qendror të zgjedhjeve në datën 19 prill 2023, me denoncues Qëndresa Qytetare, e cila pretendon që ka patur shpërdorim të burimeve publike nga Kryetari i Bashkisë Kukës. Gjatë shqyrtimit administrativ të kërkesës, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin nr. 439 datë 5 maj 2023, duke konstatuar që gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se rasti objekt denoncimi përbën shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, i ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksione marrjen e masës administrative për sanksion administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Kukës, zotit Safet Gjici , në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë dhe drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Isuf Seferi” gjobë në masën 2.500 (dy mijë e pesëqind) lekë. Nga verifikimi i elementëve formal të Kërkesës Konstatohet se i plotëson elementët formal të parashikuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte kërkojmë që të kalojë për shqyrtim administrativ në seancë publike. Faleminderit!

Z. E. Lako: Ka ndonjë pyetje nga anëtarët e Kasit?

Anëtarët e KAS-it: Jo.

Z. E. Lako: Atëherë meqenëse konstatohet se plotësohen kërkesat e nenit 130 dhe neneve të tjera të Kodit Zgjedhor që kanë të bëjnë me legjitimin, afatin dhe

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

kompetencën e KAS-it për shqyrtimin e ankimit, KAS i konsultuar në vend vendosi kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim. Do të shqyrtohet sot në orën 14:15. Faleminderit! Me kaq deklarojmë të mbyllur këtë seancë.

Vendimi nr. 77

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



08.05.2023

Ora 12:44

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 20, datë 06.05.2023, me objekt "Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ"

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHË
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaaj, Z. E. Mema
- **Parti Politike** S'ka
- **Të tjerë**

Z. L. Braho: Çelim seancën e shqyrtimit të elementëve të formës dhe të përmbajtjes të kërkesës numër 20, të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Kërkesa daton në datën 06.05.2023, me objekt "Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ me gjobë ndaj zotit Safet Gjici, Kryetar dhe njëkohësisht kandidat për Bashkinë Kukës, zotin Rustem Dervishi, drejtor i shkollës 9-vjeçare "Shaban Murati"". Të pranishëm janë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe të Sanksioneve, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së që përfaqëson në këtë proces Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Palët e interesuara janë njoftuar dhe nuk janë të pranishme. I japim fjalën Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me parashtrimet për sa i përket elementëve të formës dhe të përmbajtjes.

Z.Y.Merkaaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur denoncimi me nr. 336 ID nëpërmjet shkresës dt. 17.04.2023, me denoncues Qëndresa Qytetare,

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

e cila pretendon se ka patur shpërdorim të burimeve publike nga Kryetari i Bashkisë Kukës. Duke qenë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencën për konstatimin e kundravajtjeve administrative që e parashikon dhe ligji, ka marrë në shqyrtim këtë denoncim dhe me vendimin nr. 440 dt. 5 maj 2023 pasi ka rezultuar gjatë hetimit administrativ se rasti objekt denoncimi përbën shkelje të nenit 90 të Kodit Zgjedhor, ka vendosur ti propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masave administrative me gjobë, në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë për Kryetarin e Bashkisë Kukës, zotin Safet Gjici dhe marrjen e masave administrative në masën 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë për drejtorin e shkollës “Shaban Murati”, zotin Rustem Dervishi. Nga verifikimi paraprak i kërkesës së Komisionerit konstatohet se ajo plotëson kërkesat e elementëve formal të parashikuara në nenin 30 të Kodit Zgjedhor dhe në këto kushte i kërkojmë KAS-it ta kalojë në seancë për shqyrtim. Faleminderit!

Z. L. Braho: KAS i konsultuar në vend vendos kalimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit shtetëror të Zgjedhjeve nr. 20, dt. 06.05.2023.

Vendimi nr. 78

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



08.05.2023

Ora 12:46

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave nr. 19 dhe nr. 20, datë
06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.**


PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema
- **Parti Politike** S’ka
- **Të tjerë**

Z. L. Braho: Duke qenë se kemi të bëjmë me dy kërkesa të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që kanë të bëjnë me të njëjtin kryetar bashkie që i përket Bashkisë Kukës, vendos bashkimin e dy kërkesave. Pra bashkimin e kërkesë nr. 20 me kërkesën nr. 19 dhe shqyrtimin e tyre në një seancë të vetme me relator zotin Elvin Lako. Seanca do të zhvillohet sot në orën 14:15. Me kaq senacen e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr. 79

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 21 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 06.05.2023, me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ””.

PJESËMARRJA :

- **KAS: Z.ElvinLAKO, Z.ElvisÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ: Z. Y.Merkaj, Z. E. Mema**
- **Parti Politike S’ka**
- **Të tjerë Bashkia Konispol (J. Uzeiri)**

Z. E. Çefa: Mirëdita! Çelim seancën për vlerësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes të kërkesës numër 21 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kërkesë e cila është paraqitur përpara KAS-it me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Belsh, Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, Kryetarit të Bashkisë Cërrik, Kryetarit të Bashkisë Fier, Kryetarit të Bashkisë Elbasan, Kryetarit të Bashkisë Gramsh, Kryetarit të Bashkisë Kavajë, Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë, Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, Kryetarit të Bashkisë Konispol, Kryetarit të Bashkisë Kukës, Kryetarit të Bashkisë Lezhë, Kryetarit të Bashkisë Librazhd, Kryetarit të Bashkisë Lushnje, Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, Kryetarit të Bashkisë Përrenjas, Kryetarit të Bashkisë Pustec, Kryetarit të Bashkisë Roskovec, të Bashkisë Shijak. Për efekt të proceverbalit duhet të shënojmë faktin që ka një gabim në këtë kërkesë. Është përfshirë dhe propozuar për vendosje sanksioni administrativ edhe zoti Blerim Shera, kryetar i Bashkisë Vorë. Në fakt

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

ky propozim është shkruar gabimisht në këtë kërkesë për arsye se vendimi i Komisionerit për këtë çështje ka vendosur pushimin e procedimit për këtë person. Kështu që nga procedimi administrativ në KAS, zoti Blerim Shera, kryetar i Bashkisë Vorë do të jetë i përjashtuar. Sipas shortit të hedhur më datën 7 maj, relator i kësaj çështjeje jam caktuar unë Elvis Çefa. Verifikojmë prezencën. Është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe amdisnitrata e tij. A ka persona të interesuar prezent? Po, prezantohuni, ju lutem!

Z. J. Uzeiri: Përshëndetje! Julian Uzeiri, përfaqësues i autorizuar nga Bashkia e Konispolit.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Atëherë, në këtë fazë, kërkesa paraprake nga anëtarët e KAS-it a ka, për një konflikt të mundshëm ineteresi me ndonjë nga personat e propozuar për masë? Nuk ka. Kërkesë paraprake nga personi i tretë, a ka? Nuk ka. Atëherë, mund t'ia jap fjalën sekretarit të Përgjithshëm shkurtimisht për të bërë përmbledhjen e fakteve të kërkesës.

Z. Y. Merkaj: Atëherë Komsioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë indicie për publikim dhe postimin me përmbajtje elektorale të 20 bashkive dhe 1 kryetari bashkie për të cilat pretendohet nga denoncuesit se postimet me përmbajtje partiake në faqen zyrtare të bashkive përbëjnë shpërdorim të burimeve publike. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duke qenë se ka kompetencën për konstatimin e këtyre kundravajtjeve, ka marrë në shqyrtim këtë denoncim dhe në përfundim të shqyrtimit administrativ duke konstatuar se vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në Facebook dhe çdo mjete elektronik, media sociale të institucioneve publike për publikimin e postimeve me përmbajtje të cilat përmbajnë përmbajtje raishtag,

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

slogane me karakter politik elektoral në zgjedhje apo kthimi për mbështetje të zgjedhësve nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike. Në këto kushte i ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative në masën 3.000 (tre mijë) lekë ndaj Kryetarit të Bashkisë Belsh, Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, Kryetarit të Bashkisë Cërrik, Kryetarit të Bashkisë Fier, Kryetarit të Bashkisë Elbasan, Kryetarit të Bashkisë Gramsh, Kryetarit të Bashkisë Kavajë, Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë, Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, Kryetarit të Bashkisë Konispol, Kryetarit të Bashkisë Kukës, Kryetarit të Bashkisë Lezhë, Kryetarit të Bashkisë Librazhd, Kryetarit të Bashkisë Lushnje, Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, Kryetarit të Bashkisë Përrenjas, Kryetarit të Bashkisë Pustec, Kryetarit të Bashkisë Roskovec, të Bashkisë Shijak. Ashtu siç tha dhe relatori, kërkesa për Berim Shehin, Kryetar të Bashkisë Vorë është tërhequr nga kërkesa për marrjen e masës administrative. Në këto kushte duke parë se kërkesa e Komisionerit plotëson kriteret dhe kërkesat e nenit 130 të Kodit Zgjedhor, i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës në seancë për shqyrtim. Faleminderit!

E. Çefa: Faleminderit! Për efekt procesverbali edhe një pyetje kam. Janë njoftuar të gjitha palët e interesuara, pra kanë marrë dijeni rregullisht. Mirë, Faleminderit! Atëherë KAS i konsultuar në vend vendosi kalimin e kërkesës nr.21 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ ndaj disa kryetarëve të bashkive në territorin e Republikës së Shqipërisë. Seanca e shqyrtimit, pra e themelit do të zhvillohet në orën 13:45, pra menjëherë pas shqyrtimit të kërkesës nr. 18. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 80

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



08.05.2023

Ora 12:53

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 23 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ””.

PJESËMARRJA :

- **KAS: Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema**
- **Parti Politike S’ka**
- **Të tjerë**

Z. I. Rusmali: Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës së Komisionerit numër 23, në të cilën Komisioneri kërkon vendosjen e masës administrative gjobë për zotin Elvis Gjika, person përgjegjës për Bashkinë Kamëz. Lidhur me çështjet paraprake nuk ka deklarime konflikt interesi me anëtarët. Nuk ka përfaqësues, person të interesuar. Nuk janë prezent ndonëse janë njofuar. Ja japim fjalën Sekretarit të Përgjithshëm.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Atëherë, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar në datën 25 mars 2023 në adresën e emailit të koordinatorit me të drejtën e informimit. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është dërgar raporti nr. 14 i KRIIK-ut ku pretendohet se janë ripostuar aktivitete të postuara në faqen zyrtare të kryetarit dhe njëkohësisht kandidat për kryetar të Bashkisë Kamëz, zotit

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Rakip Suli. Duke qenë se është kompetencë e Komisionerit për shqyrtimin e konstatimeve të kundravajtjeve administrative, ka marrë në shqyrtim këtë denoncim dhe me vendimin nr. 443, datë 05.05.2023, në përfundim të hetimit administrativ, duke konstatuar se ky denoncim përbën shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor i ka propozuar KAS-it marrjen e masës administrative, sanksion në masën 3.000 (tre mijë) lekë ndaj personit përgjegjës për Bashkinë Kamëz zotit Elvis Gjika. Nga verifikimi i Komisionerit konstatohet se është në përputhje me nenin 130 të Kodit Zgjedhor, pasi plotëson të gjithë elementët formal të kërkesës. Në këto kushte i kërkojmë KAS-it ta kalojë në seacë shqyrtimin. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit zoti Merkaj! Unë kisha një pyetje në fakt. Në materialin e Komisionerit thuhet Elvis Gjika, person përgjegjës për Bashkinë Kamëz. Ky është përgjegjës për çfarë? Përgjegjës për raportimet apo ndonjë gjë tjetër?

Z. Y. Merkaj: (Pa mikrofon, nuk dëgjohet) dhe përgjegjës për Bashkinë Kamëz.

Z. I. Rusmali: Përgjegjës për mirëmbajtjen e faqes?

Z. Y. Merkaj: Dhe për mirëmbajtjen e faqes po.

Z. I. Rusmali: Vendimi nr, 9 parashikon përgjegjësi ligjore për kryetarin e bashkisë në këto raste. Ka një nen të tërë që thotë dhe detyrat specifike që duhet të plotësojë kryetari i bashkisë. Ju thjesht keni identifikuar që ky është personi që mirëmban faqen dhe është e këtij përgjegjësi e këtij postimi.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. Y. Merkaj: (Pa mikrofon, nuk dëgjohet)

Z. I. Rusmali: Atëherë, KAS vendos kalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë të komisionerit dhe zhvillimin e seancës së shqyrtimit sot në orën 15:00. Do të ishte mirë që për këtë seancë të njoftohej jo vetëm zoti Gjika që keni konfirmuar ju por edhe kryetari i bashkisë sepse eventualisht ai mund të ketë lidhje me çështjen. E mbyllim këtu seancën.

Vendimi nr. 81

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 22 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ””.

PJESËMARRJA :

- **KAS: Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ: Z. Y.Merkaj, Z. E. Mema**
- **Parti Politike S’ka**
- **Të tjerë**

Z. K. Bele: Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës së Komisionerit numër 22, me objekt “kërkesë për vendosje sanksioni administrativ me gjobë në masën 3000 (tre mijë) lekë ndaj personave si më poshtë: znj. Ledina Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; znj. Zerina Bruçi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës; z. Ismail Shehu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë; znj. Joana Duro, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; znj. Risena Xhaja, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Relator i kësaj seance jam zgjedhur unë Koli Bele sipas shortit të hedhur në datën 7 maj. Prezent është trupa e KAS-it si dhe administrata e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi. Palë të tjera prezente në këtë fazë kërkesë paraprake nuk kemi. Ftojme sekretarin shkurt pse kërkohet gjoba dhe qendrimi juaj.

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Komsioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë indicie të publikimeve me përmbajtje elektorale në rrjetin social Facebook në faqen zyrtare të 6 ministrive dhe 10 ministrave të cilat pretendohet nga denoncuesi se postimet me përmbajtje partiake në faqet zyrtare përbëjnë përdorim të burimeve publike. Referuar nenit 7 të Kodit të Procedurave Administrative, kompetenca për konstatimin të kundravajtjeve me përjashtim të rasteve kur ligji e parashkon, ndryshe i takon organit administrativ përgjegjës zbatimi i ligjit të posaçëm, në rastin konkret Komsionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i cili ka marrë në shqyrtim administrativ denoncimet e mësipërme dhe me vendimin nr. 442 dt.05.05.2023, duke vlerësuar se vënia në dispozicion e faqes zyrtare Facebook apo e çdo mjeti tjetër elektronik media sociale të institucioneve publike për publikimin e postimeve apo ripostimeve të cilat përmbajnë slogane me karakter politik elektoral në zgjedhje apo thirrje për mbështetje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike. Në këto kushte Komisioneri i ka propozuar KAS-it marrjen e masave administrative në masën 3.000 (tre mijë) lekë ndaj Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës; Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë; Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se i plotëson elementët formal të parashikuara në nenin 130 të Kodit Zgjedor. Në këto kushte i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës në seancë publike. Faleminderit!

Z. K. Bele: Në ministrinë e tjera..., pra rezulton vetën në këto ministri apo janë verifikuar gjithë ministrinë?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Nuk janë verifikuar të gjitha ministrinë...(Pa mikrofon, nuk dëgjohet).

Z. K. Bele: Me sa kuptova nga materiali është urdhëruar dhe fshirja e materialeve. Ne dijeninë tuaj janë fshirë apo nuk e keni këtë informacion?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. K. Bele: Mirë, kemi kohë ta verifikojmë deri në fillimin e seancës. Në këtë fazë nuk kemi pyetje. KAS i konsultuar në vend vendos kalimin në seancë për shqyrtimin në themel në orën 14:30. Të njoftohen palët nëse kanë interes të jenë prezent. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur!

Vendimi nr. 82

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

08.05.2023

Ora 13:42

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 18, datë 04.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Për vendosje sanksioni administrativ”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I Osmanaj
- **Të tjerë:** Bashkia Konispol

Z. E. Lako: Deklarojmë të çelur seancën e sotme për shqyrtimin në themel të kërkesës numër 18 të depozituar në datën 4.05.2023 nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me objekt, kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Donika Tula, drejtore e shkollës 9-vjeçare Todi Koçili me gjobë në masën 4,000 lek. Relator jam unë Elvin Lako. Bëjmë verifikimin e palëve pjesëmarrëse në proces. Ka ndonjë palë të interesuar? Për këtë çështje? Jo? Është prezente trupa e KAS-it, Sekretari i Përgjithshëm, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ka ndonjë kërkesë paraprake? Ndonjë konflikt, ndonjë gjë nga anëtarër e KAS-it? Jo! Atëherë vazhdojmë meqënëse nuk ka kërkesa paraprake. Zoti Merkaj, shkurtimisht dy fjalë në lidhje me çështjen.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar nëpërmjet portalit denoncimi me numër 5830 datë 03.04.2023 nga zonja Albana Vokshi, deputete Kuvendit të Shqipërisë. Për të cilën pretendohet se ka pasur përdorim të burimeve publike për qëllime zgjedhore. Referuar nenit 7 të ligjit për kundravajtjet

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

administrative, konstatohet kompetenca për konstatimin e kundravajtjeve administrative e cila shqyrtohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në këto kushte Komisioneri ka marrë në shqyrtim administrativ denoncimin e deputetes Albana Vokshi. Gjatë hetimin administrativ është konstatuar se në faqen zyrtare të rrjetit social facebook të shkollës Todi Koçeli, Selenisë është raportuar dhe është ripostuar në datën 1 prill 2023 një postim i kandidatit për kryetar bashkie zotit Nertil Bellaj për Bashkinë Selenicë për zgjedhjet e datë 14 maj 2023. Nga verifikimi paraprak dhe provat e administruara në seancë vlerësohet se në faqen e rrjetit social facebook në emrin e shkollës Todi Koçili, Selenicë e cila është në administrimin e drejtorit të shkollës, zonjës Donika Tula e cila është dhe përgjegjëse për administrimin e rrjetit social të faqes së shkollës. Në këto kushte referuar nenit 91 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatve të partive politike ose koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor të çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitalin. Është konstatuar dhe ka rezultuar se vënia në dispozicion e faqes zyrtare facebook dhe çdo elementi elektronik të institucioneve publike për publikim dhe postim të veprimtarive me karakter politik dhe elektoral në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike. Duke qenë se përdorimi i burimeve publike është konstatuar dhe ka rezultuar e provuar gjatë shqyrtimit administrativ Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur ti propozojë KAS-it marrjen e masës administrative për zonjën Donika Tula, drejtore e shkollës 9-vjeçare Todi Kaçili në masën 4,000 lek meqë faqja zyrtare e rrjetit social është në administrimin e drejtorit të shkollës. Në këto kushte kërkojmë pranimin e kërkesës sipas kërkesës se Komisionerit. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Merkaj. Meqenëse jemi këtu, një pyetje kam unë. Meqë ju e thatë që ky është ripostim i personit përgjegjës pra i zonjës Donika Tula, po personi që ka bërë postimin ka qenë pjesë e hetimit apo ka shkelje?

Z. Y. Merkaj: Gjatë hetimit administrativ, nuk është arritur të identifikohet se është postuar nga Nertil Bellaj, nga kryetari i bashkisë. Nuk është shkruar kush e ka postuar, fillimisht. Ne kemi vetëm ripostimin tek faqja e shkollës.

Z. E. Lako: Ka ndonjë pyetje?

Z. I. Rusmali: Sot që flasim është i aksesueshëm ky ripostimi në facebook? E kontrolloni dot, e verifikoni dot?

Z. Y. Merkaj: Në momentin e shqyrtimit, pra që në shqyrtimin administrativ postimi ka qenë dhe është administruar si provë. Sot besoj që mund ta ketë hequr.

Z. I. Rusmali: Mund ta verifikojmë këtë?

Z. Y. Merkaj: Po, po të marrim pak kohë, po!

Z. I. Rusmali: Dakord! E mira është para se të mbyllet shqyrtimi.

Z. L. Braho: Në çfarë date është bërë postimi?

Z. Y. Merkaj: 1 prill 2023.

Z. I. Rusmali: Po shqyrtimi?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Shqyrtimi ka qenë në datën 3 maj.

Z. I. Rusmali: Dakord! Në 3 maj ka qenë postimi. Mund të bëj edhe një pyetje tjetër?

Z. E. Lako: Po, patjetër.

Z. I. Rusmali: KAS-i ka një jurispondencë të vetën dhe ka një arsyetim që e ka përsëritur disa herë që “person i ngarkuar me detyra në kuptimin e Kodit janë vetëm personat të cilët kodi i specifikon, i specifikon si funksion dhe u specifikon dhe detyrën”. Ne kemi thënë që personat që nuk janë në këtë listë që është e fundme (është numër i kufizuar) nuk mund të merren në përgjegjësi administrative si persona të ngarkuar me detyre, por do të merren përgjegjësi administrative sipas paragrafit të dytë të nenit 171. Ju keni ardhur prap me këkesë që drejtoreshën e shkollës ta konsiderojmë si person të ngarkuar me detyre dhe ta ndëshkojmë në bazë të paragrafit të parë. Ka ndonjë motiv ekstra për këtë punë?

Z. Y. Merkaj: Ky është qëndrimi i mbajtur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe mendoj që këtë qëndrim do vazhdojë të mbajë Komisioneri.

Z. I. Rusmali: Dakord. Do të thotë, Komisioneri atë qëndrim, ne këtë qëndrim deri në fund. Mirë!

Z. E. Lako: Ka ndonjë pyetje tjetër?

Z. E. Çefa: A mund ta bëj dhe unë një pyetje?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. E. Lako: Po zoti Çefa.

Z. E. Çefa: Faleminderit. Kjo pyetje në fakt ka vlerë për të gjitha edhe procedimet e tjera që keni dhe më tepër e dua thjesht për ta saktësuar. Kur konkludoni që administrator i faqes në facebook pra i faqe zyrtare të shkollës është ky person, si e vërtetoni? Ka pohim, ka pranim të faktit nga vetë personi apo...

Z. Y. Merkaç: Po të shikosh faqen zyrtare të shkollës, atje është e shkruar vetë që kjo faqe administrohet nga filan fisteku, në rastin konkret drejtoresha e shkollës Donika Tula.

Z. E. Çefa: Qartë. Faleminderit.

Z. E. Lako: Po këtu kam një pyetje sepse po e shikoj këtë shkollën. Shoh që janë disa postime të vjetra datë 18, 19.

Znj. I. Osmanaj: Kanë qenë por i kanë fshirë.

Z. K. Bele: Mua më bën sens kur themi faqja zyrtare e KQZ-së sepse ka një IT, duhet të ketë një regjistrim por faqja zyrtare e një shkolle, nuk e di! E them këtë sepse mundet të ketë ndonjë person që pretendon ta hapi dhe mbase është një gjë që ne duhet të thellohem. Thjesht dua të kuptoj, teknikisht shkollat kanë faqe? Sepse që ta quajmë zyrtare duhet të bëjmë një lidhje midis funksionit, midis personit që e administron (e ka hapur), të drejtës së tij për ta hapur dhe për ta mbyllur. A ka ndonjë lloj rregullimi mbi këtë kuptim sepse mund të ndeshemi me raste të tjera. Bie dakord

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

në parim që, jemi të qartë ose qëndrimi im, që institucionet arsimore nuk duhet të përfshihen në... Çështja është lidhja, pra fakti që kemi një faqe zyrtare, një faqe që ne e konsiderojmë zyrtare ose Komisioneri e ka konsideruar zyrtare. Vetëm se quhet e tillë! Nuk e di! E kisha më shumë për diskutim.

Z. Y. Merkaj: Në dijeninë time nuk është se ka ndonjë rregullim të posaçëm nga Ministria e Arsimit për administrimin e faqeve të shkollave. Megjithatë duke qenë se objekti i shqyrtimit ishte një denoncim për një faqe të një shkolle e kemi marrë në shqyrtim. Por nuk mund të them që ka një rregullim për sa kohë e quajnë faqe zyrtare dhe administrohet në përgjegjësinë e drejtorit ne e kemi marrë të mirëqenë që është faqja zyrtare e shkollës.

Z. E. Lako: Faleminderit, ka pyetje? Po zoti Braho!

Z. L. Braho: Kisha një pyetje për administratën. Tani fakti që, këtë faqen e administron Donika Qirjo ju niseni vetëm nja pjesa e profilit që ka këtu facebook.com dhe tek kjo faqja del Donika Qirjo. Kjo është që ju bëni lidhjen me këtë person? Po ndonjë letërkëmbim ka pasur me...?

Z. Y. Merkaj: Në praktikën e KQZ-së që kur bëhet shqyrtimi administrativ gjithmonë i kërkojmë kërkesë për informacion të gjitha subjekteve që janë të përfshira në këtë shqyrtim. Megjithatë disa kthehenjë përgjigjë, disa nuk kthejnë. Në rastin konkret nuk kanë kthyer përgjigje.

Z. L. Braho: Faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. E. Lako: Kemi ndonjë pyetje tjetër? Po zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Meqenëse nuk dilte nga letrat dhe për të qenë në rregull me gjithçka, përfundimisht ju e konfirmoni, është shkollë publike apo private? Se mos është private dhe bëjmë ndonjë gabim. Se keni hetuar këtë!

Z. Y. Merkaj: Shkollë publike është!


Z. I. Rusmali: Dakord!

Z. E. Lako: Ju siguroj që shkollat private (se kam punuar një pjesë jete) mund të gjesh dhe universitet në të njëjtin fshat të Pogradecit për shembull. Nuk e dija që kishte! Ka shkolla të natyrave të ndryshme... Nëqoftëse s'ka pyetje tjetër, e mbyllim pjesën e hetimit administrativ. Shkurtimisht zoti Merkaj edhe njëherë, çfarë kërkoni nga KAS.

Z. Y. Merkaj: Kërkojmë miratimin ose pranimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendosjen e masës administrative në masën 4,000 lek ndaj drejtorit të shkollës 9-vjeçare Todi Kocili, zonjës Donika Tula. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit. KAS do të tërhiqet për vendim. Besoj për 10 minuta do ju thërrasim përsëri.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Di.08.05.2023

Rifillon seanca

Ora 14:08

Z. E. Lako: Atëherë në përfundim të hetimit administrativ për çështjen ankimore numër 18 KAS vendosi:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zonjës Donika Tula, drejtor i shkollës 9-vjeçare Todi Koçeli, Selenicë.

- Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zonjës Donika Tula në masën 2,500 lek, mbështetur në pikën 2, të nenit 171 të ligjit 10,019 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë së ndryshuar.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Me kaq e deklarojmë të mbyllur seancën për këtë çështje.

Vendimi nr.83

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës nr.21 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaaj, Znj. I. Osmanaj
- **Parti politike** S’ka
- **Të tjerë:** KRIIK, Qëndresa Qytetare

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve, çelim seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me numër 21, të datës 6 maj 2023, për vendosje të sanksionit administrativ, përkatësisht ndaj kryetarëve të bashkive Belsh, Bulqiz, Cërrik, Fier, Elbasan, Gramsh, Kavajë, Këlcyrë, Kolonjë, Konispol, Kukës, Lezh, Librazhd, Lushnje, Mallakastër, Përrenjas, Pustec, Roskovec dhe Shijak. Sikurse u përcaktua në seancën paraprake kjo çështje do të diskutohet në themel sot. Ju, kërkojmë ndjesë për vonesën në orarin e hapjes, për arsye objektive. Verifikojmë prezencën, është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së bashkë me administratën e tij, që në këtë procedim do të përfaqësojë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, është prezent përfaqësuesi i palës së interesuar, ju lutem prezantohuni.

**Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI**



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. I. Uzeiri: Përshëndetje, Ilirjan Uzeiri përfaqësues i autorizuar për Bashkinë Konispol.

Z. E. Çefa: Për Bashkinë Konispol? Ju, faleminderit. Atëherë meqënëse kërkesa paraprake kemi.

Z. Y. Merkaç: Vetëm vënia në dispozicion e provave të cilat i pamë nga administrata e KQZ-së vënë në dispozicion.

Z. E. Çefa: Kërkoni provat në dispozicion?

Z. Y. Merkaç: Për të verifikuar ose për të kuptuar më qartë postimin për cilin bëhet fjalë ose cila është faqja që është konsideruar si faqja zyrtare e Bashkisë Konispol nga i cili është bërë postimi i konsideruar si shkelje.

Z. E. Çefa: Dakord, po presumohet që ju me provat jeni njohur në momentin kur Komisioneri ka zhvilluar hetimin, duhet të ishit njohur me provat për sa kohë keni ardhur sot këtu dhe përfaqësoni Bashkinë Konispol, presumohet që keni djener për hetimin dhe për procedimin administrativ. Apo jo?

Z. I. Uzeiri: Po sepse tek njoftimi dhe tek vendimi nuk ishte e sqaruar konkretisht cili ishte postimi.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. E. Çefa: Dakord , atëherë administrata ju lutem një kopje të provave t'i ja vë dispozicion përfaqësuesit të Bashkisë Konispol. Atëherë sipas procedurës ja jap fjalën Sekretarit të Përgjithshëm që shkurtimisht të relatojë kërkesën e Komisionerit dhe më pas të vijoi me pyetje apo me diskutime nga pala interesuar dhe anëtarët e KAS-it, zoti Merkaj, fjala për ju.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë indicie për publikimin e postimeve me përmbajtje elektorale nga 20, bashki dhe 1 Kryetar Bashkie për sa pretendohet nga denoncuesi se postimet me përmbajtje partiake në faqen zyrtare të bashkisë përbëjnë përdorim të burimeve publike. Denoncimet janë ndërmjet provave link dhe materialeve fotografike të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë hetimit administrativ denoncuesi ka pretenduar se përgjatë periudhës parazgjedhore, prej *(nuk dëgjohet)* në datën 13 janar 2023, po ashtu edhe më parë e deri më sot, në një pjesë të konsiderueshme të faqeve zyrtare të facebook-ut, të bashkive të vendit janë përdorur slogan elektoral të Partisë Socialiste, në formë hashtagjesh, tipikisht janë përdorur slogane të bashkuar jo të ndarë “Shqipëria e Ardhmja Jonë” dhe “Ska Kohë për Pushim”. Pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre provohet se të gjitha postimet dhe ripostimet në faqen zyrtare në rrjetet sociale facebook të bashkive, subjekti i këtij denoncimi janë përdorur hashtagje me slogane me përmbajtje elektorale. Nga verifikimi paraprak i provave, vlersohet se faqet e rrjetit social facebook me emrin e bashkive, objekt denoncimi janë faqe zyrtare të këtyre institucioneve, neni 91, i Kodit Zgjedhor parashikon se nuk mund të përdoren, se nuk jemi në mbështetje të kandidatëve të partive politike ose të koalicionit në zgjedhje, burimet të organeve apo rendeve publike në nivelin Qendror ose Vendor. Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

facebook apo çdo mjete elektoral, media elektronike apo media social, institucione publike për publikimin e postimeve të cilat përmbajnë hashtagje, slogane me karakter politik elektoral në zgjedhje, janë profile për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve, përbëjnë përdorim të burimeve publike. Në këto kushte, ku Bashkitë, Belsh, Bulqiz, Cërrik, Elbasan, Fier, Gramsh, Kavajë, Këlcyrë, Konispol, Kolonjë, Kukës, Lezh, Librazhd, Lushnje, Mallakastër, Prrenjas, Pustec, Roskovec, Shijak, objekt denoncimi janë bërë një sërë publikimesh të cilat përmbajnë hashtagje dhe slogane me karakter politik, duke përdorur, duke keqpërdorur këto llogari institucionale që përbëjnë burim publik, vlersohet se jemi përpara shkeljeve administrative të Kodit Zgjedhor, pasi vërehet qartasi promovimi i subjekteve zgjedhore për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Në këto kushte Komisioneri i ka propozuar KAS-it marrjen e masave administrative në vlerën 3 mijë lekë, për kryetarët e këtyre bashkive që sapo citova.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Atëherë përpara se ti jap fjalën personit të interesuar pra përfaqësuesit Bashkisë Konispol, për sqarim kryetari i bashkisë është propozuar për gjob, për shkak se në faqen zyrtare të facebook-ut të bashkisë, është vendosur slogani “Ska Kohë për Pushim”. Apo jo? Pra kjo është shkelja ku duhet të përqëndrohet përfaqësuesi i personit të interesuar.

Z. I. Uzeiri: Po, jam duke parë pamje nga postimi i kryer dua të sqaroi se bëhet fjalë për një postim, një takim të zhvilluar, për të cilin është shqyrtuar dhe më parë nga KQZ, në lidhje me përdorimin e ambjenteve publike i cili është pezulluar. Dua të sqaroi se ky postim nuk është kryer nga Bashkia e Konispolit por është bërë nga përfaqësues të qenë prezent në këtë takim dhe më mbrapa është ripostuar ose është

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

bërë share, ky postim nga Bashkia e Konispolit. Me të marrë njoftimin Bashkia e Konispolit e ka fshirë postimin e saj dhe ripostime nëse bëhen, bëhen nga palë të tjera dhe jo nga Bashkia Konispol dhe personi që bën administrimin e faqes, Bashkia Konispol është një person i jashtëm i cili nuk ka informacionin e duhur edhe nga ana ligjore dhe për sa i përket shkeljeve ose konflikteve me dispozitat ligjore, kështuqë prandaj më mbrapa menjëherë u bë edhe fshirja e këtij postimi, edhe nuk është rikryer që me shqyrtimin e parë që është bërë për këtë shkelje.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit, unë kam një pyetje. Kur thoni se postimi fillimisht është bërë nga persona të tjerë, që kanë qënë prezent në takim dhe më pas nga faqja e facebook-ut e bashkisë është bërë ripostim. Ku i referini për kë persona konkretisht flisni? Ata që kanë bërë fillimisht postimin dhe që sipas jush kanë qënë prezent në aktivitet.

Z. I. Uzeiri: Si duket dhe nga pamjet e vëna në dispozicion është zonja Anila Demaj, ose faqja me emrin Anila Demaj e cila ka bërë postimin dhe më mbrapa është bërë share nga faqja e Bashkisë Konispol.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit. Pyetje nga kolegët? Po, zoti Braho.

Z. L. Braho: Më fal! Kush është faqja e Bashkisë Konispol? Është një Bashkia Konispol Shuaj Beqiri? Ajo është faqja? Se ajo më del në facebook mua.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. I. Uzeiri: Po, kjo është faqja e cila në fakt nuk është e miratuar diku apo ka dal me një vendim, po që kjo është faqja që përdoret aktualisht për të bërë postimet për institucionin.

Z. L. Braho: Në çfarë date është bërë ky ripostimi?

Z. I. Uzeiri: Duhet të jetë në shkurt, në fillim të shkurtit.

Z. L. Braho: Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Per administratën e KQZ-së , e kam pyetjen unë në vendimin e Komisionerit që është marrë me këtë rast, vendimi numër 441, datë 5 maj 2023, thuhet se sloganet të cilat edhe ndëshkohen nga vendimi, janë slogane që janë përdorur nga Partia Socialiste në zgjedhjet të mëparshme, në zgjedhjet e vitit 2021 në mos gaboj dhe në zgjedhjet e pjesëshme të vitit 2022. Lidhjen e tyre me fushatën aktuale, si e keni bërë ju?

Z. Y. Merkaj: Në sloganin që janë përdorur nga subjekt zgjedhor si dhe politik në zgjedhjet e 25 prill 2021 dhe në zgjedhjet 6 mars-it 2022 dhe po vazhdon të përdoret dhe në këto zgjedhje. Duke qënë se kryetarët e bashkive i kanë postuar dhe ripostuar i kanë bërë share këtyre sloganeve, atëherë është konstatuar se këto kanë përmbajtje elektorale dhe është shkelje.

Z. I. Rusmali: Janë slogane dhe të këtyre zgjedhjeve po thoni?

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Në fushatë përdoren këto slogane.

Z. L. Braho: Kisha një pyetje për rastin e Bashkisë Bulqizë. Këto postime të kujt datave janë? Ose një postim se nuk duken qartë nga këto foto që kemi ne.

Z. Y. Merkaj: Nga relatimi që bëra është marrë një periudh nga data 13 janar 2023 deri në datën e vendimit.

Z. L. Braho: Deri në datën e vendimit, se në rastin e Bashkisë Bulqizë ka një specifikë që kryetari që është tani është kryetar i komanduar, unë shoh që gjoba është propozuar ndaj zotit Lefter Alla, që mesa di unë është në masë sigurie arrest me burg, prej disa kohësh.

Znj. I. Osmanaj: Në momentin e shqyrtimit kemi patur komunikim edhe me personin përgjegjës dhe pasi është konstatuar që këto postime janë bërë në momentin që kryetar i bashkisë ka qënë në funksion, zoti Lefter Alla. Për rrjedhojë është propozuar për tu sanksionuar ky kryetar bashkie sepse postimet janë bërë në atë periudh kur ka qënë në funksion.

Z. L. Braho: Thjeshtë doja të dija. A i keni ndarë këtë kohë?

Znj. I. Osmanaj: Po, po është ndarë.

Z. L. Braho: Pra të gjithë postimet janë në kohën kur ka qënë ai kryetar i bashkisë?

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Znj. I. Osmanaj: Po, e konfirmuar kjo edhe nga personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike me Bashkinë Bulqiz.

Z. L. Braho: Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Sot që flasim janë hequr këto postime elektorale?

Znj. I. Osmanaj: Deri në datën 5 që ka qënë edhe shqyrtimi janë administruar të gjitha këto prova, edhe kanë qënë. Asnjëra nga këto nuk është hequr për sot nuk dim të themi sepse të administruara kanë qënë në datën 5 të gjitha provat.

Z. L. Braho: A mund të identifikoni ju, kush janë rastet që janë hequr që kur ka nisur hetimi nga Komisioneri? Dhe kush janë raste që kanë qënë ende të postuara deri ditën që është marrë vendimi? Pra a ka patur ndonjë lloj reagimi nga këto institucione në momentin që janë vënë në djeni që këto postime janë objekt shqyrtimi administartiv?

Znj. I. Osmanaj: Deri në datën 5 që është miratuar edhe vendimi i Komisionerit nuk është hequr asnjëra nga këto postime.

Z. K. Bele: Keni mbajtur ndonjë qëndrim KQZ-ja ndonjë akt përveç udhëzimit numër 9, që specifikisht trajton këtë problem? Apo është bërë ndonjë lloj diskutimi ndonjë trajnim, njoftim ka ndonjë lloj komunikimi me bashkitë dhe institucionet publike? Lidhur me mospërdorimin apo përdorimn.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*


Znj. I. Osmanaj: Atëherë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka organizuar edhe një takim ku janë ftuar për të marrë pjesë të gjithë përfaqësuesit e ministrive, të gjithë përfaqësuesit e bashkive sikurse edhe përfaqësuesit e institucioneve të pavarura. Për tu informuar në lidhje me këto veprimtari, sikurëse edhe ripostimet që mund të bëhen nga faqet e kryetarëve apo nga faqet e kandidatëve për kryetar. Pjesëmarrja ka qënë relativisht e ulët, në këto kushte ne kemi vijuar procedurat edhe pas thirrjeve të herë pas herëshme që kemi bërë nëpër trajnime ku janë ftuar për të marrë pjesë të gjithë palët e interesuara. Gjithashtu është bërë edhe një shkresë kujtesë ku janë listuar të gjitha detyrimet që kanë institucionet publike në kuadër të zbatimit të vendimit numër 9, Komisionit Rregullatot, kjo gjë ka ndodhur përpara datës 20 janar.

Z. K. Bele: Nëse e kuptova drejtë institucionet publike ju është komunikuar kufizimi i përdorimit të facebookut për këtë lloj qëllimi, facebook-ut të institucionit.

Znj. I. Osmanaj: Për më tepër ka edhe shumë spote nga ana e rrjeteve sociale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku herë pas here...

Z. K. Bele: Kjo është tjetër gjë se dikush e sheh dikush nuk e sheh. Në kuadër të këtij komunikimi e kisha për ty Ylli, këtë pyetje ndoshta dhe na vlen në praktikën e mëvonëshme. A është menduar që institucioneve tu vilet si e dhënë faqja zyrtare, se unë po vuaja për të gjetur një bashki të dilnin 3-4 faqe zyrtare. Pra ju e hetoni vet apo është bër një komunikim me institucionet e cila për institucionin x, flas ndoshta janë shumë institucione po ato qe janë ...

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Indiciet fillimisht vinin nga denoncimet dhe ne fillojmë shqyrtimin administrativ. Gjatë shqyrtimit administrativ bëhet komunikimi me personat përgjegjës. Në të gjitha rastet është komunikuar me personat përgjegjës, skemi patur asnjë rast që të thotë që është vjedhur faqja apo është përdorur faqja pa djeninë e titullarit.

Z. I. Rusmali: Kisha diçka në lidhje me Bashkinë Tiranë , se shoh që në denoncimin ka bërë KRIIK-u është cituar dhe një mbledhje e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë, ku ka folur kryetari i bashkisë që është njëkohësisht edhe kandidat për kryetar bashkie, mesa kuptoj është gjatë fushatës zgjedhore kjo është trajtuar nga Komisioneri sepse me sa po shoh ky aktivitet është postuar live edhe në faqen e Bashkisë Tiranë. Ka qënë kjo objekti i trajtimit nga Komisioneri?

Z. Y. Merkaj:Ashtu siç thashë dhe më përpara në shpjegimin tim, të gjitha Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kryesisht i merr këto shqyrtime administrative i merr nëpërmjet denoncimeve,

Z. I. Rusmali: Pjesë e denoncimit ka qënë edhe ky edhe fjala e kryetarit të bashkisë në mbledhjen e këshillit bashkiak, sipas denoncuesit ka patur propagand elektorale.

Z. Y. Merkaj: Atëherë mbledhja e Këshillit Bashkiak nuk është konsideruar si veprimtari.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. I. Rusmali: Desha të dija, meqënëse keqpërdorimi i burimeve publike lidhet gjithmonë me subjektin elektoral që përfiton prej tyre. Ju keni bërë hetim për përgjegjësin e subjektit elektoral që përfiton? Më konkretisht, keni indentifikuar përgjegjësit të subjektit Partia Socialiste për këto postime? Dhe pastaj keni indentifikuar përgjegjësi të kandidatëve për kryetar bashkie? Në të gjitha këto bashki, kryetarët e bashkive rezultojnë edhe kandidat apo se keni parë këtë gjë?

Z. Y. Merkaç: Jo në të gjitha këto bashki, ka bashki që kryetarët aktual, ka bashki që nuk kandidojnë kryetarët.

Z. I. Rusmali: Përgjegjësinë e kryetarit aktual kandidat për kryetar bashkie, e keni indentifikuar në raport me këtë keqpërdorim?

Z. Y. Merkaç: Jo, hetimi administrativ është shtrirë vetëm thjeshtë tek ripostimi dhe tek ripostimi i faqeve zyrtare të këtyre sloganeve.

Z. I. Rusmali: Ka motiv ligjor për mos shqyrtimin e kësaj gjëje? Se dispozitë e Kodit është dhe ajo.

Z. Y. Merkaç: Tani tek denoncimet ky ka qënë objekti, hetimi duhet të jetë i thellë i gjithëanshëm i lartë edhe i gjërë, por ne jemi fokusuar vetëm te denoncimet.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. I. Rusmali: Mesa mbaj mend unë raportet e KRIIK-ut pothuajse në të gjitha përmëndet fakti që hetimi duhet të zgjerohet edhe tek përgjegjësia e subjektit elektoral sepse ndryshe nuk vlerë, kështu i kam lexuar unë mbase i kam lexuar gabim.

Z. Y. Merkaç: Kështu mund të jetë dhe më e mira për ta bërë por do të kthehem si Prokurori e Përgjithëshme pastaj, duhet të kemi kohë shumë në dispozicion të Burimeve Njerzore, mendoj që jemi fokusuar thjeshtë vetëm tek denoncimet që janë bërë dhe nuk i kemi shtrirë më tepër shqyrtimin.

Z. E. Çefa: Dakord atëherë, pyetje të tjera nuk ka. Përfundimisht çfarë kërkoni zoti Sekretar i Përgjithshëm në emër të Komisionerit?

Z. Y. Merkaç: Pranimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendosjen e masave administrative në vlerën 3 mijë lekë për kryetarët e bashkive të cituara më sipër, faleminderit.

Z. E. Çefa: Përfaqësuesi i Bashkisë Konispol çfarë kërkoni përfundimisht nga KAS-i? Lidhur gjithmonë me bashkinë që ju përfaqësoni.

Z. I. Uzeiri: Kërkojmë rrëzimin e kësaj kërkesë pasi nuk shikojmë përgjegjësi direkte të subjektit në fjalë për një postim i cili është bërë nga një person tjetër, në kuadër të një takimi i cili ka qënë vetëm për shqyrtimin e ankesave të ardhura nga këshilli dhe nga kryepelqësia le të themi, për probleme konkrete të banorëve, është përfshirje e Bashkisë Konispol pa miratim të vetë titullarit ose pa postim direkt të

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Bashkisë Konispol, i është dhënë ky kronotacion pa patur një qëllim të caktuar ose pa patur për qëllim fushatë, aq më tepër që është rasti që u përmend që nuk është kandidat për kryetar bashkie.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit, atëherë në këtë fazë ne do të tërhiqemi për vendim, do të na duhen 10 minuta ose 15 minuta. Rreth 10-15 minuta kohë dhe pastaj do ju thërrasim që të shpallim vendimin. Faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 15:10

Z. E. Çefa: Riçelim edhe njëherë seancën për dhënien e vendimit për kërkesën nr. 21 të Komisionerit “Për vendosje sanksioni administrativ”. KAS pasi e diskutoi çështjen në tërësi vendosi:

- Në bazë të nenit 172, paragrafi i parë i Kodit Zgjedhor, të merret masa administrative gjobë në masën në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë ndaj z. Arif Tafani, z. Andis Salla, z. Armando Subashi, z. Gledian Llatja, z. Redjan Krali, z. Klement Ndoni, z. Erion Isai, z. Safet Gjici, z. Pjerin Ndreu, znj. Eriselda Sefa, z. Qerim Ismailaj, z. Nuri Belba, z. Pali Kolefski, znj. Majlinda Bufi, z. Elton Arbana, në cilësinë e subjekteve zgjedhore që kanë përfituar direkt nga shkelja.
- Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për pjesën tjetër të kërtimeve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

- Ndaj këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të ushtrojnë ankim brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 84

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



RENDI I DITËS

Projektakti "Për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 19 dhe 20 datë 06.05.2023, me objekt "Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** LZHK
- **Të tjerë:** KRIIK, Qëndresa Qytetare

Z. E. Lako: Atëherë, deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin në themel të kërkesave nr.19 dhe nr.20 të depozituar në datën 6.05.2023 nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me objekt kërkesë për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Safet Gjici kryetar dhe kandidat për Bashkinë Kukës, gjobë në masën 10 mijë lekë. Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zotit Betim Lushi Drejtor i Shkollës 9 vjeçare "Isuf Seferi" gjobë në masën 2 mijë e 500 lekë dhe kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zotit Rustem Dervishi Drejtor i Shkollës 9 vjeçare "Shaban Murati" gjobë në masën 2 mijë e 500 lekë. Në seancën paraprake të orës 12 e 45 duke qenë se të dyja kërkesat ankimore kanë të njëjtin objekt u vendos bashkimi i tyre në mbështetje të nenit 19 pika 1 të vendimit nr.3 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator për mënyrën e zhvillimit të seancave të KAS. Meqenëse për kërkesën e parë kam qenë unë relatori jam edhe për këtë kërkesë jam

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

unë Elvin Lako. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes bëjmë verifikimin e palëve pjesëmarrëse në mbështetje të nenit 133 të Kodit Zgjedhor dhe nëse nuk ka ne përsëri do të vazhdojmë me vazhdimin e seancës edhe në mungesë të tyre. Për administratën është Sekretari i Përgjithshëm dhe përfaqësues të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ka palë të interesuara?

Qëndresa Qytetare: Dhimitër Zguro dhe Rigels Xhemollari.

Z. E. Lako: Jepni shpjegim çfarë lidhje keni me....

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresa Qytetare”: Kemi lidhje me kërkesën e Komisionerit pasi jemi në rolin e denoncuesit.

Z. E. Lako: Pra ju jeni ato që keni iniciuar procedurën hetimore.

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresa Qytetare”: Po, jemi ato që kemi iniciuar procedurën dhe në të njëjtën kohë ditën e sotme kemi depozituar edhe dy ankime të pjeshme përsa i takon vendimeve të Komisionerit, të cilat lidhen me mos ndëshkimin administrativ me gjobë ndaj zonjës Dallëndyshe Bici. Faleminderit!

Z. E. Lako: Përsa i përket kërkesës për pjesëmarrjen si palë e interesuar jeni personat e njohur nga administrata dhe keni depozituar kërkesë pranë sekretarisë.

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresa Qytetare”: Po.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. E. Lako: Mirë, faleminderit! Ka ndonjë kërkesë paraprake për anëtarët e KAS apo ndonjë konflikt interesi ? Jo, nuk kemi. Për sa i përket kërkesës për palë të interesuara. Atëherë, KAS vendosi që ju të merrni pjesë në proces si palë e interesuar. Nëse nuk ka kërkesa paraprake vazhdojmë me shqyrtimin në themel të çështjes, fillimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm shkurtimisht në lidhje me të dy kërkesat që u bashkuan në një, çfarë ka ndodhur shkurtimisht.

Z. Y. Merkaç: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur denoncimet me numër 335 dhe 386 ID me denoncues “Qëndresa Qytetare” e cila pretendon se ka pasur përdorime të burimeve publike nga Kryetari i Bashkisë Kukës dhe nga Drejtori i shkollës 9 vjeçare “Isuf Seferi” në fshatin Fshat dhe është drejtori i shkollës Rustem Dervishi drejtori i shkollës “Shaban Murati” në Kukës. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen ka vlerësuar se informacioni i dhënë nga “Qëndresa Qytetare” ka treguar një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ dhe me vendimin nr.440 dhe 439. Datë 5 Maj 2023 ka shqyrtuar administrativisht denoncimet e organizatës “Qëndresa Qytetare” ndaj Kryetarit të Bashkisë Kukës dhe Drejtorit të Përgjithshëm Agjensisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorit të Shkollës 9 vjeçare Shaban Murati dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në shkelje të Kodit Zgjedhor për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se me datën 16 Prill 2023 në ambjentet e jashtme të shkollës 9 vjeçare në Ujmisht të zhvillojë një takim me mes kandidatëve të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit njëherazi dhe Kryetari i Bashkisë zotit Safet Gjici me banorë të fshatit. Gjithashtu në këtë takim ka qenë dhe shoqëruar nga zonja Dallëndyshe Bici Drejtore e Përgjithshme e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës. Po me datën 16 Prill 2023 në ambjentet e jashtme të shkollës 9 vjeçare “Isuf Seferi” në fshatin Fshat është zhvilluar një takim mes


*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, edhe njëherazi kryetari i Bashkisë së Kukësit zotit Safet Gjici me banorët e fshatit Fshat. Në vijim gjatë hetimit administrativ është zhvilluar në datën 24 Prill 2023, gjatë procesit administrativ është dhënë e drejta dhe janë shprehur për të dhënë shpjegimet në lidhje me çështjen dhe palët që janë pjesëmarrëse në këtë proces administrativ. Në përfundim të hetimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve është provuar se veprimtaria me karakter elektorale është kryer në ambjentet e jashtme të insitucioneve publike, konkretisht në ambjentet e Shkollës 9 vjeçare “ Shaban Murati dhe Shkollës 9 vjeçare Isuf Seferi. Është vërtetuar se në këtë takim ka pasur deklarime elektorale dhe thirrje për mbështetje të kandidatëve për Kryetar Bashkie, është provuar se Kryetari i Bashkisë Kukës njëkohësisht kandidati për kryetar i bashkisë me zhvillimin e fushatës elektorale me mbylljen e shkollave 9 vjeçare, është konstatuar se ka përdorur burimet publike në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore. Gjatë hetimit administrativ nuk është provuar se pjesëmarrja e zonjës Dallëndyshe Bici të jetë në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës pasi takimet e zhvilluara nuk provojnë që të kenë pasur lidhje me detyrën funksionale dhe institucionale të këtij personi. Referuar veprimtarive të mësipërme me objekt denoncimi ka rezultuar e provuar se veprimtaritë me karakter elektorale janë kryer në ambjentet e shkollave në Ujimisht dhe Fshat ambjente të cilat nuk kanë rrethim po i përkasin oborrit të institucionit. Gjithashtu është vërtetuar se në këto takime ka pasur deklarime thënie elektorale dhe thirrje për mbështetje të kandidatit për Kryetar Bashkie. Referuar edhe nenit 91 pika 1 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se nuk mund të përdoret ose të vihen në mbështetje të kandidatëve të partive politike ose koalicioneve në zgjedhje buirme të organeve apo enteve publike në nivel qendror dhe vendor. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka paraqitur KAS propozimin për marrje mase administrative ndaj kryetarit të Bashkisë Kukës zotit

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Safet Gjici në masën 10 mijë lekë dhe ndaj drejtorit të Shkollës 9 vjeçare “Shaban Murati” në vlerën 2 mijë e 500 lekë dhe drejtorit të shkollës 9 vjeçare “Isuf Seferi” në masën 2 mijë e 500 lekë. Gjithashtu ka përshkruar edhe hetimin administrativ për Drejtoren e Përgjithshëm të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës për zonjën Dallëndyshe Bici me arsyetimin që bëra pak më lartë. Në këto kushte i kërkojmë KAS pranimin e kërkesës për vendosjen e masave administrative ndaj Kryetarit të Bashkisë zotit Safet Gjici dhe dy drejtorave të shkollave. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Merkaj! I jap fjalën përfaqësuesit për palën e interesuar në lidhje me rastin në fjalë.

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresa Qytetare”: Faleminderit! Sikurse është provuar edhe gjatë hetimit administrativ nga ana e kandidatit të Partisë Socialiste Safet Gjici për Bashkinë e Kukësit. Janë përdorur ambjentet e shkollave 9 vjeçare publike me qëllim zhvillimin e veprimtarisë zgjedhore dhe mbështetjen e këtij kandidati në zgjedhje më konkretisht shkolla “Isuf Seferi” dhe “Shaban Murati”, në njësinë Grykëcaji dhe në njësinë Ujmisht në njësinë administrative të Ujmishtit. Në këtë veprimtari përveçse ka pasur thirrje të ndryshme elektorale edhe nga zoti Safet Gjici po edhe nga pjesëmarrësit një veprimtari kjo që e ritheksoi edhe njëher që është një veprimtari e ndaluar në kuptim të nenit 3 të vendimit nr.9 dhe nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Kemi edhe praninë e zonjës Dallëndyshe Bici 3 cila është Drejtore e Përgjithshme e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, e cila në referim të nenit 6 të ligjit organik për kadastrën është një agjensi në varësinë e drejtëpërdrejtë të Kryeministrit dhe vetë titullari zonja Dallëndyshe Bici emërohet dhe shkarkohet nga ana e Kryeministrit. E kemi gjetur deri diku të pa bazuar edhe gati absurd pretendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përse i takon mos ndëshkimit të zonjës

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Dallëndyshe Bici me gjobë duke vlerësuar se kjo pjesëmarrje është bërë gjatë një fundjave, për sa i takon detyrave funksionale dhe në referim të ligjit për Kadastrën por edhe në referim të Kodit të Punës dhe të legjislacionit shqiptar marrëdhënia e punës nuk përfundon me arritjen e ditës së Shtunë ose të Diel, marrëdhënia e punës përfundon në momentin e largimit nga detyra ose në momentin e shkarkimit. Zonja Dallëndyshe Bici as nuk është larguar nga detyra gjatë kohës që ka qenë prezente në këtë takim gjithashtu ka bërë edhe thirrje duke përdorur edhe funksionin e saj zyrtar edhe për këtë do të doja të (dëgjohet inçizimi audio i zónjës Dallëndyshe Bici në aktivitet). Në vijim të këtyre thirrjeve jo vetëm në njësinë administrative Ujmisht në shkollën e Lusnit po edhe në shkollën tjetër në njësinë administrative të Grykçajës zonja Bici jo vetëm që ka bërë thirrje në funksionin e saj si titullare e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës po i ka nxitur qytetarët që të votojnë Partinë Socialiste duke premtuar edhe investime dhe zhvillimin e Bashkisë së Kukësit si kur më parë ndër të tjera zonja Bici. Ka bërë një mbështetje të jashtëzakonshme ndaj zotit Gjici si kandidat dhe për rrjedhojë ne kemi gjetur vendimin e Komisionerit për sa i takon pjesës të mos ndëshkimit të zónjës Bici të pa bazuar. Në të njëjtën kohë do ti kërkojmë anëtarëve të KAS shtrirjen e hetimit administrativ edhe ndëshkimin edhe të subjektit zgjedhor përfitues që në këtë rast është Partia Socialiste, e cila nëpërmjet përdorimit të burimeve publike, ka krijuar një favorizim edhe ka përfituar disa avantazhe të paligjshme dhe të pa drejta në favor të saj dhe të kandidatit të saj. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit! Kam dy pyetje meqenëse çfarë dëgjuam këtu edhe për administratën për zotin Sekretar të Përgjithshëm por edhe për ju si palë e interesuar edhe me ankimet tani u njohëm sepse tani na u vu në dispozicion dhe në funksion të hetimit që ti kemi edhe ne në këtë fazë të qarta pretendimet tuaja. Por të fillojmë me

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

zotin Sekretar të Përgjithshëm duke pasur parasysh edhe nga çfarë u tha këtu që këto takime elektorale janë bërë në fundjavë dhe mjediset e përdorura të shkollës janë oborri lexova diku që janë edhe pa mure rrethuese apo pa dyer. Keni bërë ndonjë hetim ju? Që cili është aseti që është përdorur, aseti publik çfarë është quajtur në fundjavë? Se unë i kam parasysh pak a shumë edhe këto njësitë që ju përmendët, që këto shkollat janë aty diku në qendrat në fshatin Fshat apo ku di unë. Nuk e di se mund të jetë edhe një shesh i fshatit, a është bërë një hetim që kjo është pjesë e shkollës? Çfarë lidhje ka me shkollën? Se mund të jetë një vend në fshat që aty bëhen takimet në funksion të hetimit e kam këtë.

Z.Y. Merkaj: Siç e thashë edhe në shpjegimet e mija gjatë hetimit administrativ është bërë një verifikim dhe ka konstatuar se të dyja ambjentet, në të dy shkollat, ambjentet e jashtme janë pa rrethim por janë i përkasin oborrit të institucionit. I përkasin oborrit të shkollës. Godina e parë ka qenë pa rrethim që i përket oborrit të institucionit...


Z. E. Lako: Domethënë janë bërë me ndonjë qëllim aty? Apo nuk ka ku të zhvillohet në ndonjë vend tjetër në fshat?! Ska vend. Cila ka qenë lidhja me shkollën? Apo thjesht është përdorur sheshi...

Z.Y. Merkaj: Thjesht është përdorur oborri i shkollës...

Z. E. Lako: Sepse nuk ka pasur vend tjetër ku të ushtrohet? Apo ka pasur ndonjë lidhje specifike me....

Z.Y. Merkaj: Këtë nuk e dimë nëse ka pasur apo jo vend tjetër por ne kemi hetuar që ky takim është bërë tek oborri i shkollës 9 vjeçare.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*


Z. E. Lako: Po. Ndërsa për palën e interesuar në funksion të asaj çfarë dëgjuam, dua konkretisht cila është lidhja e zonjës Bici? Çfarë ka shkelur nga përshkrimi i detyrave të veta i funksionit që mban? Konkretisht çfarë akti ka shkelur, që ka marrë pjesë në një aktivitet elektorale? Po e marrim të mirëqenë atë audion që dëgjuam që është pjesë e fjalës nga ky takim që është zhvilluar. Po cili është konkretisht shkelja e pretenduar prej jush?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresa Qytetare”: Neni 3 veprimtaritë e ndaluara parashikon: Pika 2, “Kryeministri, administrata e tij, Zv.Kryeministri, Ministri dhe Zv.Ministri administrata e tyre, Kryetari Bashkisë zëvendësit, dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, Drejtori Përgjithshëm i Agjensive” apo institucionet në varësi të Kryeministrit dhe renditen një sër funksionarësh të tjerë gjatë periudhës 4 mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarë do lloj forme në veprimtaritë e ndaluara sipas këtij vendimi. Një nga veprimtaritë e ndaluara është edhe përdorimi i ambjenteve publike siç është shkolla.

Z. E. Lako: Ka ndonjë pyetje nga anëtarët e tjerë? Po zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Për këtë rast për të dyja këto raste ka rëndësi të analizohet mirë, çështja e raportit midis aktivitetit dhe përgjegjësisë së institucionit ka një justifikim që të del në këto letra që thonë që oborri është pa rrethim.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Znj. I. Osmanaj: Nga hetimi pasi kemi administruar edhe videon dhe e kemi verifikuar këtë gjë, shkolla është pa rrethim po duket mjaft qartë që oborri është pjesë e kësaj shkolle. Është oborr funksional për këtë shkollë.

Z. I. Rusmali: Përveç kësaj thuhet që shkolla nuk ruhet, keni identifikuar ju përgjegjësinë e drejtuesit të shkollës? Ai që ka përgjegjësinë e administrimit të asetit në raport me aktivitetin publik? Se një shkollë është pa rrethim ,një shkollë është me rrethim. Të dyja shkollat nuk ruhen, do të thotë që njerzit edhe mund të futen edhe vetë edhe ta bëjnë aktivitetin pa dijeninë e personave përgjegjës. Dijeninë e personave përgjegjës e keni hetuar ju?

Znj. I. Osmanaj: Kemi kërkuar informacion nga ZVA-ja Kukës dhe kemi administruar edhe përgjigjen që ata kanë qenë në dijeni të kësaj veprimtarie.


Z. I. Rusmali: Përgjegjësinë administrative të Kryetarit të Bashkisë ku e mbështesni juve? Keni vendosur që ti jepet gjobë Kryetarit të Bashkisë në bazë të nenit 171 pika 1. Si personi i ngarkuar me detyra ai nga ana tjetër është edhe subjekt zgjedhor, cila është detyra që ka pasur Kryetari i Bashkisë në raport me ngjarjen? Çfarë shkelje ka bërë ai në funksion me detyrën?

Z. Y. Merkaç: I ka përdorur burimet publikë në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore si kandidat.

Z. I. Rusmali: Si ka kandidatë ka përdorur asete publike? Si Kryetar bashkie?

Zbardhi materialin audio

Ardita CAMI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Ka vënë këto asetet në funksion në përdorim të kandidatit së vetës së tij.

Z. I. Rusmali: Po është përgjegjës për administrimin e aseteve?

Z. Y. Merkaj: Po, është Kryetari i Bashkisë.

Z. I. Rusmali: Kryetari i bashkisë, po drejtori i shkollës?

Z. Y. Merkaj: Edhe drejtori janë të dy, prandaj është marrë masa për ...

Z. I. Rusmali: Është përgjegjësi e dyfishtë administrimi?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. E. Lako: Po zoti Braho!

Z. L. Braho: Kisha një pyetje për administratën, për rastin e zonjës Dallëndyshe Bici. Se nuk e kuptova, ajo nuk është propozuar sanksion administrativ meqenëse atje ka qenë rolin e bijës së fshatit Fshat, ky është i vetmi justifikim?

Z. Y. Merkaj: Ka qenë pranë miqve dhe familjes së saj ka marrë pjesë rastësisht, kanë shkuar dhe ka pasur mik... dhe nuk vërtetohet lidhja midis takimit dhe postit që mban si Drejtore e Agjensisë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Z. L. Braho: Po pjesa e fjalimit që thotë “unë si drejtoreshë që kam qenë në këtë qeveri”. Se tani nuk e di se si mund të lidhet me pjesëmarrësit? Si mundet ta bëni lidhjen? Ju jeni bazuar vetëm tek deklarimi i saj tek shkresa tek email? Në rregull.

Z. E. Lako: Meqë nuk ka më pyetje, shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm ju kërkoni që?

Z. Y. Merkaj: Pranimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendosjen e sanksionit administrativ në masën 10 mijë lekë për Kryetarin e Bashkisë Kukës zotin Safet Gjici dhe marrjen e masës administrative për zotin Rustem Dervishi Drejtor i Shkollës 9 vjeçare “ Shaban Murati” në vlerën 2 mijë e 500 lekë dhe Drejtori i Shkollës Betim Lushi, Drejtori i Shkollës 9 vjeçare “Isuf Seferi” në masën 2 mijë e 500 lekë.

Z. E. Lako: Faleminderit! Pala e interesuar?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresa Qytetare”: Kërkojmë pranimin pjesërisht të kërkesës së Komisionerit duke ndëshkuar zotin Gjici sipas nenit 172 pika 1 në masën e gjobës 500 mijë lekë dhe njëkohësisht kërkojmë dënimin e drejtorëve të shkollave dhe zonjës Bici sipas nenit 171 pika 2. Dënimin e subjektit zgjedhor Partia Socialiste. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit! KAS do të tërhiqet për vendim për 10-15 minuta do tui thërrasim përsëri.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.05.2023*

Rifillon Mbledhja

Ora 16:03

Z. E. Lako: Atëherë, shpallim vendimin për kërkesat ankimore, kërkesat për vendosje sanksioni nr.19 dhe nr. 20. Në përfundim të hetimi Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve me shumicë votash vendosi:

- 1.Pranimin e pjesshëm të kërkesësave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe palës së interesuar.
 - 2.Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Safet Gjici Kryetari i Bashkisë Kukës sipas nenit 172 pika 1 gjobë në masën 100 mijë lekë.
 - 3.Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zonjës Dallëndyshe Bici, zotit Rustem Dervishi dhe zotit Betim Lushi sipas nenit 171 pika 1 gjobë në masën 2 mijë e 500 lekë.
 4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 5. Për pikën 2 mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
 6. Për pikën 3 mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në Tiranë brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.
- Me kaq e deklaroj të mbyllur këtë seancë.

Vendimi nr. 85

*Zbardhi materialin audio
Ardita CAMI*

